

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	622-26-1534-2-1-1
Nr i brendshëm	622-26-004-2-1-1

Sa i përket tenderit për: “Shqyrtimet laboratorike për projektet e investive kapitale-projekt tre vjeçar”.

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

IMK BALLKAN PROJEKT SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

M2,Prishtinë-Ferizaj

(Adresa)

Graçanicë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

+38344/111-719

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Shabi Binaku

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Ballkanprojekt.pr@gmail.com

(Adresa elektronike)

24.09.2026

(Data e parashtrimt të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit



Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

Prishtinë

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Data e njoftimit për kontratë: 23.03.2026
Hapja e ofertave: 05.05.2026
Njoftimi mbi vendimin e AK-së I: 09.07.2026
Njoftimi mbi vendimin e AK-së II: 08.09.2026
Kërkesë për rishqyrtim: 14.09.2026
Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 14.09.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

X

Jo

☐

Bashkangjitur gjeni vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

Neni 97.1 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Vendimi i P.SH. nr. 2026/0530.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar, ne me dt.09.07.2026 kishim pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku ishte rekomanduar për kontratë OE N.SH. Test&Ing, ndërsa ne ishim shpallur si tenderues i eliminuar me arsyetimin si në vijim:

[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

1. Menaxheri i Projektit i emruar me vendim nuk posedon certifikatën e kërkuar të dëshmitë si në kërkesën dy të kapacitetit teknik dhe profesional në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontrat.
2. Iso Standartet i mungojnë (të pa qarta dhe nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara si në dosje të tenderit).
3. Ju mungojnë pajisjet teknike si në kërkesën 5 të kapacitetit teknik dhe profesional.

Kundër këtij vendimi, ne me datë 14.07.2026, kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, të cilën AK e ka refuzuar si të papabazuar me datë 15.07.2026.

Duke qenë e pakënaqur me këtë vendim, ne kemi parashtruar ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) me datë 25.07.2026, e evidentuar me nr. protokolli 2026/0530. Në kuadër të kësaj procedure, OSHP me datë 27.07.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për shqyrtimin e dosjes dhe pretendimeve ankimore, i cili me datë 30.07.2026 ka dorëzuar

Raportin e Ekspertit Shqyrtues nr. 2026/0530, me rekomandimin që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur në këtë raport dhe në administrimin e provave, Paneli Shqyrtues i OSHP-së, me Vendimin OSHP: 2026/0530 të datës 28.08.2026, ka vendosur si në vijim:

Aprovohet, si pjesërisht e bazuar, ankesa e OE "IMK BALLKAN PROJEKT" SH.P.K.; Anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK-së, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim;

Në arsyetimin e këtij vendimi, Paneli Shqyrtues, duke u mbështetur në konstatimet e Ekspertit Shqyrtues, ka gjetur si të bazuara/të qëndrueshme të tri pretendimet e OE ankues, përkatësisht:

Pretendimi 1 (Menaxheri i Projektit / akreditimi DAK): Eksperti ka konstatuar se, sipas Ligjit Nr. 05/L-117 për Akreditim, DAK nuk parasheh akreditim personal, dhe se akreditimi i dhënë OE ankues me komplet stafin dhe pajisjet e plotëson këtë kriter – pretendimi i bazuar.

Pretendimi 2 (Certifikatat ISO): Eksperti ka konstatuar se OE ka ofruar certifikatat ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018, siç kërkohen në dosjen e tenderit – pretendimi i qëndrueshëm.

Pretendimi 3 (Pajisjet teknike): Eksperti ka konstatuar se OE ka ofruar listën e nënshkruar/vulosur të pajisjeve, marrëveshje qiraje për mjetet që nuk i posedon, librezë regjistrimi dhe DUD/fatura – pretendimi i qëndrueshëm.

Paneli Shqyrtues, duke iu referuar nenit 104 par. 1 dhe nenit 1 të LPP-së, ka urdhëruar shprehimisht AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit t'i përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Megjithatë, tani pas rivlerësimit me njoftimin mbi vendimin (B58) të datës 08.09.2026, të nxjerrë në zbatim të Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0530, autoriteti kontraktues na ka eliminuar përsëri, duke e rekomanduar për kontratë po të njëjtin operator ekonomik N.Sh. Test&Ing Suharekë, në të njëjtën vlerë, duke u bazuar në thelb në të njëjtat tri arsye që Paneli Shqyrtues i OSHP-së i kishte vlerësuar tashmë si të bazuara/të qëndrueshme: (i) mungesa e certifikatës/akreditimit personal të Menaxherit të Projektit nga DAK; (ii) mospranimi i certifikatave ISO (tani me arsyetimin se "nuk rezultojnë të verifikueshme online"); dhe (iii) mungesa e pajisjeve teknike (kamioni special për shpim dhe pajisja për matjen e integritetit të pilotave).

Përkatësisht ne tani jemi eliminuar me arsyen e njëjtë sikurse në njoftimin mbi vendimin e dt.09.07.2026, shih arsyet e eliminimit:

Gjatë fazës së rivlerësimit të tenderit, komisioni në përputhje me autorizimet e LPP-së dhe rregullores për prokurim publik ka konstatuar se OE, ka; Mungesë e dëshmisë së kërkuar për Menaxherin e Projektit – OE nuk ka dorëzuar certifikatën/dëshminë e kërkuar të akreditimit për personin e emruar me vendim Menaxher të Projektit, i cili sipas kërkesës duhet të jetë Inxhinier i Gjeodezisë, me Licencë A dhe i certifikuar nga Departamenti i Akreditimit i Kosovës (DAK), pra menaxherit të projektit i mngon certifikata nga DAK.

Certifikatat ISO – dokumentet ISO të paraqitura nga OE nuk rezultojnë të verifikueshme online, ndonëse verifikueshmëria e tyre është përcaktuar si kërkesë në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë. Për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet e dëshmuar përmbushja e kësaj kërkesë në mënyrën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues.

Mungesa e pajisjeve teknike të kërkuara – OE nuk ka dëshmuar posedimin dhe/ose disponueshmërinë e pajisjeve të kërkuara për realizimin e kontratës, konkretisht:

- Kamion special për shpim, minimum 6 tonë;
- Pajisja për matjen dhe testimin e integritetit të pilotave.

Ky veprim i AK-së ku përsëri na ka eliminuar me arsyetimin e njëjtë, përbën mosrespektim të drejtpërdrejtë të Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0530, i cili është përfundimtar dhe detyrues për autoritetin kontraktues (neni 117 i LPP-së), pasi rivlerësimi është kryer në kundërshtim me urdhrin e Panelit Shqyrtues për t'iu përmbajtur dispozitave ligjore të LPP-së, duke ripërsëritur

pikërisht ato arsye eliminimi që janë gjetur si të pabazuara. Ndryshimi formal i formulimit të arsyes së dytë (nga "certifikata të paqarta" në "nuk verifikohen online") nuk përbën një rivlerësim të mirëfilltë dhe të pavarur, por vetëm një riformulim të së njëjtës konkluzion tashmë të kundërshtuar nga OSHP-ja.

Duke mos kryer një rivlerësim të mirëfilltë dhe të pavarur, por duke ripërsëritur formalisht të njëjtin vendim eliminimi, AK-ja ka shkelur autoritetin dhe efektin detyrues të Vendimit të OSHP-së (neni 117 i LPP-së), duke rënë njëkohësisht në shkelje të rëndë sipas nenit 97.1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, konkretisht paragrafët:

- d) – mosrespektim i parimeve themelore të prokurimit publik, përmes trajtimit jo të barabartë të OE ankues krahasuar me operatorin e rekomanduar për kontratë; dhe*
- e) – mosrespektim i rregullave për trajtimin e kërkesave për rishqyrtim/rivlerësim.*

Për shkeljet e tilla të rënda, neni 99 i po kësaj Rregulloreje parasheh masa disiplinore ndaj zyrtarit/zyrtarëve përgjegjës të prokurimit, deri në revokim ose pezullim të certifikatës profesionale të prokurimit (neni 99.1–99.2).

Nëse eventualisht autoriteti kontraktues nuk do të kthejë lëndën në rishqyrtim, pa dashur që një gjë e tillë të cilësohet si kërcënim, ne do të jemi të detyruar të kërkojmë nga OSHP-ja që ta konstatojë këtë mosrespektim të Vendimit nr. 2026/0530 si shkelje të rëndë në kuptim të nenit 97.1 (d) dhe (e) të Rregullores Nr. 001/2022, dhe ta referojë rastin te KRPP-ja për shqyrtimin e përgjegjësisë disiplinore të zyrtarit/zyrtarëve të prokurimit të KUVENDIT KOMUNAL TË PRIZRENIT që kanë hartuar/nënshkruar Njoftimin B58 të datës 08.09.2026.

Përkundër faktit që pretendimet tona ankimore janë aprovuar si të bazuara nga OSHP-ja, me Vendimin nr. 2026/0530 të datës 28.08.2026, ne edhe njëherë po e sqarojmë se arsyet e AK-së për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit janë të paqëndrueshme për faktet si në vijim:

Sa i përket arsyes së parë të AK-së ku është cekur se Menaxheri i Projektit i emëruar me vendim nuk posedon certifikatën e kërkuar sipas kërkesës së kapacitetit teknik dhe profesional. Ky konstatim është i pabazuar dhe në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar në ofertën tonë.

Në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit, ne kemi emëruar z. Fatmir Bajrami si Menaxher të Projektit, i cili i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara, respektivisht është inxhinier i diplomuar i gjeologjisë, posedon përvojën e kërkuar profesionale, Licencën A, është i trajnuar për Siguri dhe Shëndet në Punë, si dhe është pjesë e personelit të laboratorit të akredituar nga Drejtoria e Akreditimit e Kosovës (DAK).

Në ofertën tonë është dorëzuar Certifikata e Akreditimit e laboratorit "IMK BALLKAN PROJEKT" Sh.P.K., së bashku me dokumentacionin shoqërues të saj. Në pikën 6.2 "Personeli" të dokumentit të akreditimit figuron shprehimisht z. Fatmir Bajrami, M.Sc. i Gjeologjisë, si pjesë e personelit të laboratorit të vlerësuar nga DAK sipas standardit SK EN ISO/IEC 17025:2018. Dokumenti përfundon me konstatimin zyrtar se laboratorit i plotëson kërkesat e pikës 6.2 të këtij standardi, duke konfirmuar se kompetenca e personelit është verifikuar gjatë procesit të akreditimit.

Kërkesa e dosjes nuk ka kërkuar paraqitjen e një certifikate individuale të akreditimit për Menaxherin e Projektit, pasi DAK nuk lëshon certifikata individuale për personelin, por akrediton laboratorin dhe gjatë këtij procesi vlerëson edhe kompetencën e personelit të tij. Pikërisht për këtë arsye, dokumentacioni zyrtar i akreditimit përmban listën e stafit të vlerësuar, ku figuron edhe z. Fatmir Bajrami.

Autoriteti kontraktues nuk ka identifikuar se cili dokument mungon apo cili kusht nuk është përmbushur nga z. Fatmir Bajrami, por është mjaftuar me një konstatim të përgjithshëm se ai

nuk posedon certifikatën e kërkuar. Një arsyetim i tillë nuk është i bazuar në faktet e ofertës dhe nuk përmbush standardin e arsytimit të vendimeve administrative. Përderisa ne kemi dorëzuar dokumentacionin që dëshmon se z. Fatmir Bajrami është pjesë e personelit të akredituar nga DAK dhe i plotëson edhe të gjitha kërkesat e tjera të dosjes së tenderit, eliminimi ynë mbi këtë bazë është i pabazuar dhe nuk qëndron.

Autoriteti kontraktues ka interpretuar në mënyrë të gabuar kërkesën e dosjes së tenderit, duke e trajtuar akreditimin e DAK si një certifikatë individuale të Menaxherit të Projektit. Në realitet, sipas sistemit të akreditimit të DAK dhe standardit SK EN ISO/IEC 17025:2018, akreditimi i jepet laboratorit, ndërsa kompetenca e personelit vlerësohet dhe evidentohet në dokumentacionin zyrtar të akreditimit. Për rrjedhojë, dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ne e përmbush plotësisht kërkesën e dosjes së tenderit dhe nuk ekziston bazë ligjore për eliminimin e ofertës mbi këtë arsye.

Duhet sqaruar fakti se për OE të rekomanduar për kontratë, rezulton se për përmbushjen e kësaj kërkeje është pranuar vetëm një certifikatë e pjesëmarrjes në trajnim të organizuar nga Drejtoria e Akreditimit e Kosovës për standardin SK EN ISO/IEC 17025. Kjo certifikatë dëshmon vetëm ndjekjen e trajnimit dhe nuk përbën certifikatë akreditimi apo dëshmi se personi është vlerësuar dhe kompetent sipas standardit në fjalë. Për rrjedhojë, nëse autoriteti kontraktues ka konsideruar se një certifikatë e pjesëmarrjes në trajnim është e mjaftueshme për përmbushjen e kësaj kërkeje, atëherë nuk ka asnjë bazë ligjore që ne të eliminohemi nga aktiviteti i prokurimit, përderisa kemi dorëzuar dokumentacion edhe më të plotë dhe më bindës.

Theksojmë se kjo pikërisht ishte edhe konstatimi i Ekspertit Shqyrtues të OSHP-së në raportin nr. 2026/0530, i cili konstatoi se sipas Ligjit Nr. 05/L-117 për Akreditim, DAK-u nuk parasheh akreditim personal për menaxherë projekti dhe se akreditimi i dhënë OE ankues, me komplet stafin dhe pajisjet e nevojshme, e plotëson këtë kriter konstatim ky i mbështetur edhe nga paneli shqyrtues i OSHP-së, i cili e vlerësoi pretendimin tonë si të bazuar. AK-ja, duke ripërsëritur po të njëjtën arsye eliminimi, pa asnjë fakt apo dokument të ri, e ka shpërfillur hapur këtë konstatim tashmë të prerë të OSHP-së.

Autoriteti kontraktues tek arsyeja e dytë për eliminimin tonë ka dhënë arsyetimin se: "ISO Standardet i mungojnë (të pa qarta dhe nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara si në dosje të tenderit)."

Kjo arsye e eliminimit është e paqartë dhe e pabazuar, pasi ne kemi dorëzuar të gjitha certifikatat ISO të kërkuara në dosjen e tenderit, të cilat janë në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara nga AK-ja.

Autoriteti kontraktues në arsyen e saj për eliminimin tonë nuk ka specifikuar se në çfarë konsiston arsyetimi se certifikatat "i mungojnë", janë "të paqarta" apo "nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara", duke e bërë të pamundur identifikimin e ndonjë mangësie konkrete në dokumentacionin e dorëzuar.

Për më tepër, nëse autoriteti kontraktues ka pasur çfarëdo dileme lidhur me certifikatat e dorëzuara, ai ka mundur, në përputhje me nenin 59.2 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, të kërkojë sqarime nga ne si operator ekonomik ose të verifikojë drejtpërdrejt vlefshmërinë e tyre pranë kompanisë që i ka lëshuar këto certifikata. Duke mos i shfrytëzuar dispozita ligjore dhe duke u mjaftuar me një konstatim të përgjithshëm e të paargumentuar, AK-ja ka nxjerrë një përfundim të pabazuar në gjendjen faktike dhe në dokumentacionin e dorëzuar nga ne dhe njëkohësisht na ka diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Në njoftimin B58 të datës 08.09.2026, të nxjerrë pas rivlerësimit të urdhëruar nga OSHP-ja,

AK-ja e ka riformuluar këtë arsye eliminimi, duke pretenduar tani se "dokumentet ISO të paraqitura nga OE nuk rezultojnë të verifikueshme online, ndonëse verifikueshmëria e tyre është përcaktuar si kërkesë në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë." Ky arsyetim i ri mbetet po aq i pabazuar, pasi vetë Eksperti Shqyrtues i OSHP-së, në raportin nr. 2026/0530, ka konstatuar shprehimisht se OE ka ofruar të gjitha certifikatat e kërkuara sipas pikës 9.1 dhe 9.2, kërkesa nr. 4, të Dosjes së Tenderit (ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018), dhe se AK duhet të veprojë në përputhje me nenin 59 dhe 72 të LPP-së konstatim që Paneli Shqyrtues e ka vlerësuar si të qëndrueshëm.

AK-ja as tani nuk specifikon përmes cilit sistem apo databaze ka tentuar verifikimin, dhe as ka kërkuar sqarime shtesë nga ne siç e lejon/kërkon neni 59.2 dhe 72 i LPP-së, para se të na eliminojë sërish mbi këtë bazë.

Autoriteti kontraktues na ka eliminuar tek arsyeja e tretë me arsyetimin: "Ju mungojnë pajisjet teknike si në kërkesën 5 të kapacitetit teknik dhe profesional."

Ky arsyetim është i pabazuar dhe në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar nga ne. Në përputhje me Kërkesën 5 të Dosjes së Tenderit, ne kemi dorëzuar listën e mjeteve të punës, të nënshkruar, me dëshmitë të cilat janë kërkuar nga AK-ja, përmes të cilave vërtetohet fakti se pajisjet e prezantuara nga ana jonë, janë në harmoni me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Për më tepër, nëse autoriteti kontraktues ka pasur ndonjë paqartësi ose dilemë lidhur me listën e pajisjeve të dorëzuara apo dokumentacionin përkatës, ai ka mundur, në përputhje me nenin 59.2 dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, të kërkojë sqarime nga ana jonë përpara marrjes së vendimit për eliminim, por që një veprim të tillë nuk e ka ndërmarr, duke na diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit. Duke mos kërkuar sqarime dhe duke mos identifikuar konkretisht se cilat pajisje pretendohet se mungojnë, autoriteti kontraktues ka nxjerrë një përfundim të pabazuar, i cili nuk mbështetet në dokumentacionin e dorëzuar dhe nuk mund të përbëjë bazë ligjore për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit.

Në njoftimin B58 të datës 08.09.2026, AK-ja tashmë e ka saktësuar këtë arsye duke specifikuar se na mungojnë konkretisht: "Kamion special për shpim, minimum 6 tonë" dhe "Pajisja për matjen dhe testimin e integritetit të pilotave." Edhe ky arsyetim i saktësuar mbetet i pabazuar, pasi vetë Eksperti Shqyrtues i OSHP-së, në raportin nr. 2026/0530, ka konstatuar shprehimisht se, ashtu siç janë kërkuar dëshmitë në dosjen e tenderit për listën e mjeteve të punës, OE ka ofruar listën e nënshkruar dhe të vulosur të pajisjeve të kërkuara, marrëveshje qiraje për mjetet që nuk i posedon në pronësi, librezat regjistrimi për mjetet e regjistrueshme, si dhe DUD-at doganorë apo faturat e shitblerjes – konstatim që Paneli Shqyrtues e ka vlerësuar si të qëndrueshëm. AK-ja nuk sqaron pse ky dokumentacion, tashmë i vlerësuar pozitivisht nga OSHP-ja, konsiderohet befasisht i pamjaftueshëm për këto dy pajisje specifike.

Prandaj kur kemi parasysh faktet e lartcekura, kuptohet qartë se autoriteti kontraktues na ka eliminuar pa ndonjë bazë ligjore dhe në kundërshtim të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit, vendimit të OSHP-së dhe dispozitave ligjore.

Ne me dt.14.09.2026 kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim, ndërsa po me këtë datë kemi pranuar edhe vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku AK-ja siç duke pa e analizuar fare kërkesën tonë ka bërë refuzimin e saj të pa mbështetur në ndonjë dispozitë ligjore apo ndonjë fakt konkret që dëshmojë kundërtën e pretendimeve tona ankimore.

Vendimi i AK-së nuk prezanton asnjë fakt apo dokument të ri krahasuar me arsyet e eliminimit

të dhëna në njoftimin B58 të datës 08.09.2026, të cilat tashmë janë vlerësuar dhe janë gjetur të pabazuara nga paneli shqyrtues i OSHP-së me vendimin nr. 2026/0530. ZPP-ja e Komunës së Prizrenit, në cilësinë e organit që vendos mbi kërkesën për rishqyrtim, ka mbetur në të njëjtin qëndrim formal, duke mos u marrë në mënyrë të pavarur me pretendimet konkrete të parashtruara nga ne, çka përbën shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 117 të LPP-së (efekti detyrues i vendimit të OSHP-së) dhe të nenit 97.1 (d) e (e) të Rregullores Nr. 001/2022.

Sa i përket pretendimit tonë ankimor në lidhje me ISO certifikatën, vendimi i datës 14.09.2026 pranon shprehimisht se "Komisioni **nuk ka arritur** të bëjë verifikimin online të standardeve ISO". Ky formulim tregon qartazi se problemi nuk qëndron te dokumentacioni ynë, por te pamundësia/dështimi i vetë Komisionit të AK-së për të kryer verifikimin – rrethanë që nuk mund të na ngarkohet neve si operator ekonomik.

Certifikatat ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018 janë lëshuar nga një organizëm certifikues i identifikueshëm, i cili mund të kontaktohet drejtpërdrejt për konfirmimin e vlefshmërisë së tyre. Autoriteti Kontraktues, në rast dyshimi ose pamundësie teknike për verifikim online, ka pasur në dispozicion – dhe sipas nenit 59.2 dhe nenit 72 të LPP-së edhe **detyrimin** – që para se të nxjerrë një vendim eliminues, të kërkojë sqarime shtesë nga ne si OE dhe/ose të verifikojë drejtpërdrejt vlefshmërinë e certifikatave pranë vetë organizmit certifikues që i ka lëshuar ato (p.sh. përmes email-it apo korrespondencës zyrtare me kompaninë certifikuese), veçanërisht kur sistemi online i vetë AK-së rezulton i pamjaftueshëm ose jofunksional për këtë qëllim.

AK-ja nuk ka ndërmarrë asnjërin nga këto veprime. As nuk specifikon nëpërmjet cilit sistem/databazë ka tentuar verifikimin, as nuk sqaron pse nuk është kontaktuar organizmi certifikues lëshues për konfirmim direkt, çka do të ishte mënyra më e drejtpërdrejtë, më e sigurt dhe më objektive për të shmangur çdo paqartësi. Kjo arsye e AK-së është e paqëndrueshme, aq më tepër kur vetë eksperti shqyrtues i OSHP-së, në raportin nr. 2026/0530, ka konstatuar shprehimisht se certifikatat e kërkuara janë ofruar në përputhje me pikat 9.1 dhe 9.2, kërkesa nr. 4, të Dosjes së Tenderit.

Sa i përket pretendimit tonë të dytë në lidhje me pajisjet teknike, AK-ja në vendimin e saj përsërit një konstatim të përgjithshëm ("pajisjet nuk janë paraqitur... nuk janë mbështetur me dëshmi") pa e dëshmuar këtë pohim me dokumentacionin konkret të dorëzuar nga ne (lista e nënshkruar/vulosur e mjeteve, marrëveshjet e qirasë, librezat e regjistrimit, DUD-të/faturat), dokumentacion që vetë eksperti shqyrtues i OSHP-së e ka vlerësuar si të mjaftueshëm. Mungesa e çdo sqarimi mbi atë se cili dokument specifik konsiderohet mangët, krahasuar me atë çka OSHP-ja tashmë e kishte gjetur të plotë, e bën këtë arsye të paqëndrueshme, prandaj arsyetimin e AK-së ne e shohim si tendencioz me qëllimin që të mos rekomandohemi për kontratë ne si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë.

Për korrektësi dhe për njoftim të OSHP-së, gjatë këtyre ditëve kemi pranuar një email njoftues nga kompania që ka lëshuar certifikatat tona, INVICTA ASSURANCE INTERNATIONAL (SHPK), përmes të cilit jemi njoftuar se kompania e mëparshme SIGMACERT DOO, me seli në Mal të Zi, ka zhvendosur selinë në Shqipëri dhe ka ndryshuar emrin e kompanisë në INVICTA ASSURANCE INTERNATIONAL (SHPK). Në këtë njoftim është bërë e ditur se certifikata e akreditimit me numër IAS MSCB-136 është transferuar në kompaninë e re pa ndryshime, ndërsa numri i akreditimit dhe fusha e akreditimit kanë mbetur të njëjta. Gjithashtu, jemi njoftuar se për kompanitë, auditimet e mbikëqyrjes të të cilave janë të planifikuara pas datës 04.08.2026, rinovimi i certifikatave do të bëhet nën emrin INVICTA ASSURANCE INTERNATIONAL (SHPK). Për këtë arsye, nëse OSHP-ja e sheh të arsyeshme, për të hequr çdo paqartësi lidhur me autenticitetin, vlefshmërinë dhe statusin e certifikatave të dorëzuara nga ana jonë, mund të kontaktojë drejtpërdrejt kompaninë që i ka lëshuar certifikatat në adresën zyrtare elektronike info@isocert.bg, e cila mund të japë konfirmimin

përkatës zyrtar lidhur me certifikatat tona.

Sa i përket pretendimit tonë të tretë në lidhje me Menaxherin e Projektit, AK-ja është arsyetuar se dëshmia "nuk është paraqitur fare", mirëpo një arsyetim i tillë është faktikisht i pasaktë, përderisa Certifikata e Akreditimit të laboratorit tonë nga DAK, e dorëzuar në ofertë, e përmban shprehimisht z. Fatmir Bajrami në pikën 6.2 "Personeli", si pjesë e stafit të vlerësuar sipas standardit SK EN ISO/IEC 17025:2018, **fakt ky i konstatuar dhe i pranuar tashmë nga vetë OSHP-ja në Vendimin 2026/0530.**

Nga ato që u thanë më lartë sqarojmë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim, nuk përbën një rivlerësim të mirëfilltë, të pavarur dhe në përputhje me urdhrin e OSHP-së, por një riafirmim formal të të njëjtit eliminim tashmë të konstatuar si të pabazuar, të nxjerrë pa shfrytëzuar mjetet ligjore që LPP-ja i vë në dispozicion AK-së (nenet 59.2 dhe 72) për sqarimin e paqartësive drejtpërdrejt me palët e interesuara përfshirë edhe rastin e ISO-s, e edhe me vetë organizmin lëshues të certifikatave.

Kur kemi parasysh të gjitha të lartcekurat kuptohet qartë se AK-ja na ka diskriminuar që nga fillimi në këtë aktivitet të prokurimit, me qëllimin e vetëm që të favorizohet OE i rekomanduar për kontratë, ndërsa ne si OE të përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë të eliminohemi nga aktiviteti i prokurimit, me arsye të cilat nuk janë të qëndrueshme dhe të mbështetura në dispozita ligjore.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përkitazi me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe OE të tjerë, prandaj duhet rishqyrtuar edhe njëherë ky aktivitet i prokurimit me të gjitha dëshmitë e ofruara.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se sepse nuk jemi rekomanduar për kontratë edhe pse jemi OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë.**

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë, ndërsa ne edhe i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi shpall fitues i këtij tenderi.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që *"gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse"*, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse ne edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit nuk jemi rekomanduar për kontratë.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE IMK BALLKAN PROJEKT SH.P.K

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurat ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.